

Familja e Thaçit
i falënderon qytetarët dhe
institucionet për nderimet
dhe ngushëllimet

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NË PAT PASZGJEDHOR: ASNJË DISKUTIM ZYRTAR PËR QEVERINË E RE

FACE 4-5



Ngërçi paszgjedhor në
Kosovë vazhdon, pa asnjë
diskutim zyrtar për qeverinë

e re. Opozita pranon se
bisedime joformale po
zhvillohen në prapaskenë,

ndërsa Lëvizja Vetëvendosje
këmbëngul se do të qeverisë
vetme

KONJUFCA SHKON
PËR NGUSHËLLIME
TE FAMILJA E
THAÇIT, FLET FJALË
TË MËDHA PËR
HAXHI THAÇIN

F. 5



BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES
NË MES TË KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE
KROACISË NERVOZON SERBINË

F. 3



AMBASADA AMERIKANE SHPREH
NGUSHËLLIME PËR NDARJEN NGA
JETA TË HAXHI THAÇIT

F. 3


KGJK-ja MIRËPRET OPINIONET E
KOMISIONIT TË VENECIAS PËR
REFORMËN NË DREJTËSI

F. 7

POLICIA E KOSOVËS I ARRESTON 16
TË DYSHUAR PËR KONTRABANDË TË
ARMËVE, PËRFSHIRË NJË ZYRTAR
POLICOR

F. 6

EKONOMI




OYTETARËT NUK MUND T'I
PËRBALLOJNË ÇMIMET E LARTA

F. 8

"PROTESTAT DO TË JENË
TË VAZHDUESHME",
KUNDËRSHTOHET FUQISHËM
SHTRENTIMI I RRYMËS

F. 8

SPORT



KOSOVA LUAN SOT PËR FITORE
NDAJ ISLANDËS

F. 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pas bisedës me Trumpin, Putini pajtohet t’i ndalë sulmet në sektorin e energjisë në Ukrainë

WASHINGTON, 19 MARS - Gjatë bisedës telefonike me presidentin amerikan Donald Trump, presidenti rus, Vladimir Putin, është pajtuar t’i ndalë sulmet ndaj sektorit të energjisë të Ukrainës dhe infrastrukturës për 30 ditë, si një hap drejt arritjes së një armëpushimi të plotë. Sipas njoftimeve për telefonatën e zhvilluar më 18 mars - që zgjati mbi 90 minuta - nga Kremli dhe Shtëpia e Bardhë u tha se janë të përkushtuar për arritjen e një marrëveshjeje për paqe afatgjatë me qëllim që t’i jepet fund luftës në Ukrainë. “Udhëheqësit janë pajtuar se lëvizja drejt paqes të fillojë me një armëpushim për energjinë dhe infrastrukturën, por edhe negociata teknike për zbatimin e një armëpushimi detar në Detin

e Zi, një armëpushim të plotë dhe paqe të përhershme. Këto negociata do të nisin menjëherë në Lindjen e Mesme”, u tha në njoftimin e lëshuar nga Shtëpia e Bardhë. Në njoftimin e lëshuar nga Kremli lidhur me bisedën, që u karakterizua si “e detajuar dhe këmbim i singertë i pikëpamjeve”, u tha se Putini “paraqiti një sërë pikash të rëndësishme lidhur me sigurimin e kontrollit efektiv mbi një armëpushim të mundshëm përgjatë vijës së frontit, nevojën për ta ndaluar mobilizimin e detyruar në Ukrainë dhe riarmatosjen e Forcave të Armatosura të Ukrainës. “U theksua se kushti kyç për ta parandaluar përkallëzimin e konfliktit dhe për të punuar drejt zgjidhjes së tij përmes mjeteve



politike dhe diplomatike duhet të jetë ndalimi i plotë i ndihmës së huaj ushtarake dhe i ndarjes së informacioneve të inteligjencës me Kievin”, tha Kremli. Pas bisedës Trump - Putin, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se gjithmonë shteti i

tij ka mbështetur idenë që të mos sulmohen caqet energetike, ato në det, transporti dhe objektet e prodhimit ushqimor. “Tani duhet të kuptojmë cilat janë detajet e kësaj marrëveshjeje. Nuk i dimë ato. Pa Ukrainën, këto gjëra thjesht nuk mund të jenë

realiste”, tha ai. Duke folur për pjesën e mobilizimit, kërkesë e paraqitur nga Putini, Zelensky tha se udhëheqësi rus nuk flet në aspektin humanitar, por synon “që ta bëjë ushtrinë tonë më të vogël e më të dobët”. “E njëjta gjë vlen edhe për kërkesat e tij për të ndaluar ofrimin e ndihmës ushtarake dhe inteligjencës për ne”, tha ai. Presidenti ukrainas tha se nuk beson se partnerët e shtetit të tij do ta pranojnë kërkesën e Putinit që t’i ndalë dërgesat me armë për Ukrainën. Në njoftimin e Kremlit u tha se bisedimet e paqes “duhet ta marrin parasysh nevojën absolute për t’i eliminuar shkaqet thelbësore të krizës dhe interesat legjitime të Rusisë në zonën e sigurisë”.

Turqia e arreston rivalin kryesor të Erdoganit, i dyshuar për korrupsion

ANKARA, 19 MARS - Autoritetet turke e kanë arrestuar të mërkurën Ekrem Imamoglu, rivalin kryesor të presidentit Recep Tayyip Erdogan, nën dyshimin për korrupsion dhe mbështetje të një grupi terrorist. Partia kryesore opozitare e ka cilësuar arrestimin e tij “tentim për puç kundër presidentit tonë të ardhshëm”. Arrestimi i Imamoglut - kryetarit të njohur të Stambollit - vjen në një kohë kur shumë figura opozitare janë ndaluar në gjithë vendin, që është cilësuar nga shumë si përpjekje e politizuar për t’i heshtur kundërshtarët. Qeveria e Erdoganit i ka hedhur poshtë kritikën, duke thënë se gjyqësori është i pavarur. Megjithatë autoritetet ndaluan përkohësisht protestat dhe policia mbylli disa rrugë të qytetit, rreth



100 persona u mbledhën para stacionit policor ku u dërgua Imamoglu dhe brohoritën: “Do të vijë dita kur AKP-ja do të japë llogari”. Imamoglu, 54 vjeç, prin para Erdoganit në disa prej sondazheve në Turqi. Ai është duke u hetuar në dy raste të ndara, të cilat përfshijnë akuza për drejtimin e një organizate kriminale, ryshfet dhe manipulim me tenderë. Partia kryesore opozitare, Partia

Republikane Popullore (CHP), ishte në prag ta shpallte Imamoglu kandidat për president për ta sfiduar Erdoganin, i cili ka udhëhequr Turqinë për më shumë se dy dekada. Zgjedhjet e ardhshme janë planifikuar për vitin 2028, por Erdogani e ka arritur kufirin e lejuar prej dy mandatesh si president, pasi më parë ka shërbyer si kryeministër. Nëse dëshiron të garojë përsëri për president, ai duhet të shpallë zgjedhje të parakohshme dhe të pretendojë se nuk e ka përfunduar mandatin e dytë, ose i duhet ta ndryshojë Kushtetutën. Erdogani pësoi disfatën më të rëndë zgjedhore në zgjedhjet komunale mbarëkombëtare vitin e kaluar, kur CHP-ja e Imamoglut fitoi qytetet kryesore të Turqisë dhe mposhti partinë e tij në pushtet,

AKP, në bastionet e saj. Në një video të publikuar në rrjetet sociale, Imamoglu tha se nuk do të dorëzohet dhe se do të vazhdojë të qëndrojë i palëkundur përballë trysnisë. Lideri i CHP-së, Ozgur Ozel, e quajti arrestimin e Imamoglut përpjekje për grusht-shteti dhe u bëri thirrje të gjitha grupeve opozitare të bashkohen kundër ndalimit të tij. Ai shtoi se partia do ta zgjedhë Imamoglu lider të dielën pavarësisht prej zhvillimeve. Sipas një komunikate nga zyra e prokurorit të Stambollit për hetimin e parë, gjithsej 100 njerëz, përfshirë gazetarë dhe biznesmenë, dyshohen se janë përfshirë në aktivitete kriminale të lidhura me tenderë të caktuar të lëshuar nga bashkia e Stambollit. Në hetimin e dytë, prokurorët e akuzojnë Imamoglu dhe gjashtë

persona të tjerë për mbështetjen e Partisë së Punëtorëve Kurdistanë, PKK, e cila konsiderohet organizatë terroriste nga Turqia dhe aleatët e saj perëndimorë. Muajin e kaluar PKK-ja shpalli armëpushim në përgjigje të thirrjes së liderit të burgosur, Abdullah Ocalan, për çarmatim, duke shënuar një hap të madh drejt përfundimit të një kryengritjeje që ka lënë mbi 40 000 të vdekur dhe që mund të ketë pasojë të rëndësishme për sigurinë rajonale dhe politiken. Arrestimi i Imamoglut ndodhi një ditë pasi Universiteti i Stambollit e shfuqizoi diplomën e tij, vendim i cili, nëse konfirmohet, do ta pengonte atë të garojë në zgjedhjet presidenciale. Zyra e guvernatorit të Stambollit ndaloi të gjitha tubimet dhe protestat në qytet për katër ditë.

Ulqinakët kërkojnë anulimin e tenderit për dhënien me qira të plazheve

ULQIN, 19 MARS - Qiramarrësit e deritanishëm të plazheve të Ulqinit kërkojnë anulimin e tenderit që e fitoi një investitor i huaj, i cili bëri ofertën më të lartë për t’i marrë me qira plazhet e qytetit në Mal të Zi. Përveç kësaj, ata kërkojnë zgjatjen e kontratave të qirasë të lidhura vitin e kaluar, me të njëjtat kushte. Kjo u bë me dije në një konferencë për medie më 18 mars. Kërkesat e tyre janë mbështetur edhe nga kryetari i komunës, Genci Nimanbegu. Tenderi për qiranë katërvjeçare të plazheve të Ulqinit ka shkaktuar revoltë mes qiramarrësve të deritanishëm dhe autoriteteve

lokale, të cilët besojnë se plazhet po u lihen investitorëve të huaj “përmes marrëveshjeve të dyshimta të arritura pas dyerve të mbyllura”. “Një sulm i organizuar dhe i paprecedentë, i sinkronizuar me institucionet e sistemit, ka ndodhur gjatë tenderit të zgjatur, në të cilin ka marrë pjesë kompania Eagle Hills Montenegro”, ka vlerësuar Nimanbegu një ditë më parë. Kompania arabe Eagle Hills ka paraqitur ofertat më të larta për numrin më të madh të plazheve në Plazhin e Madh në Ulqin, të cilat deri më tani janë dhënë me qira kryesisht sipërmarrësve vendas. Pas shpalljes më 11 mars se Eagle



Hills ka “fituar” numrin më të madh të plazheve, u organizua një protestë, ku u tha se kjo është e papranueshme për popullsinë lokale.

Më pas investitori arab bëri një ofertë për banorët lokalë. Nga kompania Eagle Hills u bë me dije se, në rast se marrin plazhet me qira, do t’ua lënë

qiramarrësve të deritanishëm me çmimin që ata kanë ofruar në tender. Kështu tha më 16 mars Mohamed Alabbara, kryetari i Eagle Hills Properties. “Kjo vendimmarrje reflekton përkushtimin e zotit Alabbara për t’i mbështetur bizneset lokale, për t’i ruajtur burimet e jetesës dhe për të investuar në infrastrukturën e plazheve”, u tha në deklaratë. Kryetari i Shoqatës së Qiramarrësve të Plazheve në Ulqin, Prela Shkrela, tha se një qiramarrës nuk mund ta japë sërish me qira plazhin dikujt tjetër. “Për këtë nuk ka bazë ligjore dhe askush nga ne nuk do ta pranonte”, tha ai.

Krasniqi me qindra zyrtarë dhe anëtarë të PDK-së shkojnë për ngushëllime te familja Thaçi

SKENDERAJ, 19 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga qindra zyrtarë të lartë të partisë, anëtarë të Kryesisë, deputetë, kryetarë komunash dhe aktivistë, ka vizituar të mërkurën familjen Thaçi, për t'i shprehur ngushëllime pas ndarjes nga jeta

të Haxhi Thaçit, babait të ish-presidentit Hashim Thaçi. Në këtë vizitë ngushëllimi përfaqësuesit e PDK-së shprehën dhembjen dhe solidaritetin e tyre me familjen Thaçi, duke kujtuar figurën e Haxhi Thaçit si një njeri të urtë dhe të përkushtuar për familjen

dhe atdheun. Kryetari Memli Krasniqi vlerësoi kontributin dhe vlerat e larta njerëzore të Haxhi Thaçit, duke theksuar se ai do të kujtohet gjithmonë me respekt dhe mirënjohje. PDK-ja qëndron pranë familjes Thaçi në këtë kohë zie.



AMBASADA AMERIKANE SHPREH NGUSHËLLIME PËR NDARJEN NGA JETA TË HAXHI THAÇIT

PRISHTINË, 19 MARS - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të Haxhi Thaçit, babait të ish-presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçit. Në një mesazh ngushëllimi drejtuar familjes Thaçi, e Ngarkuara me Punë në Ambasadën Amerikane, Anu Prattipati, theksoi dhembjen e thellë për këtë humbje dhe shprehu mbështetjen e saj për familjarët e të ndjerit. "Ne e kuptojmë humbjen e thellë për të gjithë ju dhe duam t'ju shprehim ngushëllimet tona të sinqerta gjatë kësaj kohe të vështirë. Uroj që të gjeni forcë dhe ngushëllim në kujtimet që keni ndarë dhe në mbështetjen e atyre që ju rrethojnë", thuhet në mesazhin e Ambasadës.



Ambasada Amerikane qëndron pranë familjes Thaçi dhe të gjithë të dashurve të Haxhi Thaçit në këto çaste të dhimbshme. Ish-presidentit Thaçi nuk i është lejuar pjesëmarrja në varrimin e të atit nga Gjykata Speciale në

Hagë. Haxhi Thaçi u varros të martën në varrezat e fshatit Burojë të Skenderajt, ku morën pjesë mijëra qytetarë nga anembanë Kosova, por edhe përfaqësues të institucioneve të Shqipërisë e të Maqedonisë së Veriut.

Telegrami i plotë i ngushëllimit:

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
Prishtinë, Kosovë
18 mars 2025

Familja Thaçi
Fshati Burojë, Komuna e Skenderajt
Republika e Kosovës

Për familjen e Haxhi Thaçit:
Në emër të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, dëshiroj të shpreh ngushëllimet e mia për ndarjen nga jeta të Haxhi Thaçit. Ne e kuptojmë humbjen e thellë për të gjithë ju, dhe duam t'ju shprehim ngushëllimet tona të sinqerta gjatë kësaj kohe të vështirë. Uroj që të gjeni forcë dhe ngushëllim në kujtimet që keni ndarë dhe në mbështetjen e atyre që ju rrethojnë. Ju lutemi, pranoni ngushëllimet tona të sinqerta dhe dijeni se mendimet tona janë me ju dhe të dashurit tuaj.

Me respekt,
Anu Prattipati
E Ngarkuar me Punë

KONJUFCA SHKON PËR NGUSHËLLIME TE FAMILJA E THAÇIT, FLET FJALË TË MËDHA PËR HAXHI THAÇIN

SKENDERAJ, 19 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka shkuar për ngushëllime në familjen Thaçi në Burojë të Skenderajt pas vdekjes së babait të ish-presidentit Hashim Thaçi, Haxhi Thaçi. Konjufca pas ngushëllimeve është nënshkruar edhe në Librin e Zisë. Ai ka thënë se Haxhi Thaçi ka qenë një patriot, i cili e ka ushqyer me patriotizëm familjen e vet dhe gjithë Drenicën. "Të gjithë e kemi njohur si patriot të madh e plak të urtë. E ka ushqyer me



patriotizëm familjen e vet dhe gjithë këtë pjesë të Drenicës. Mbi të gjitha, e ka frymëzuar

me patriotizëm djalin e tij Hashim Thaçin që ishte president i Kosovës dhe bartës

i shumë proceseve në të cilat kemi kaluar. Edhe gjatë viteve '90 prej Lëvizjes Studentore e deri në krye të UÇK-së. Bashkë me bashkëveprimtarët e tij, të cilët po e mbrojnë kauzën në Hagë. Me bacën Jakup, Rexhep Selimin, Kadri Veselin, të cilët kanë qenë në krye të UÇK-së, falë së cilës erdhi liria. Kjo nuk do të ndodhte pa inspirimin e frymëzimin që e kemi prej prindërve tanë, ashtu siç Thaçi e ka pasur prej bacës Haxhi", ka thënë Konjufca, i cili i ka dërguar edhe një telegram ngushëllimi familjes

Thaçi. "E nderuara familje Thaçi. Me pikëllim mora lajmin se u nda nga jeta Haxhi Thaçi. Në emrin tim dhe në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës ju shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për humbjen e më të dashurit tuaj! Ndonëse nuk është më në këtë jetë, Haxhi Thaçi do të jetë i pranishëm në kujtimet që ka lënë pas, në zemrat e atyre që e patën pranë dhe ndanë jetën me të. U prehtë në paqe!", thuhet në telegramin e kryetarit Konjufca.

Familja e Thaçit i falënderon qytetarët dhe institucionet për nderimet dhe ngushëllimet

SKENDERAJ, 19 MARS - Pas përfundimit të ceremonisë së varrimit të të ndjerit Haxhi Thaçi, babait të ish-presidentit Hashim Thaçi, familja Thaçi i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në homazhet e sotme, mbledhjen përkujtimore dhe varrimin e kryefamiljarit të tyre. "I falënderojmë të gjithë qytetarët për mbështetjen. I

falënderojmë delegacionet nga Shqipëria, Maqedonia dhe të gjitha trevat shqiptare për nderimet, si dhe institucionet e Kosovës për telegramet e ngushëllimit. Pjesëmarrja masive e qytetarëve, mbështetja e tyre duke na qëndruar afër këto ditë, na e zbut dhimbjen dhe na e bënë më të lehtë t'i kalojmë këto ditë të rënda", ka thënë Idriz

Thaçi, vëllai i ish-presidentit Hashim Thaçi. Ai e ka falënderuar edhe personelin shëndetësor të QKUK-së për kujdesin dhe profesionalizimin e treguar për babanë e Thaçit gjatë këtyre tre muajve. Njëherësh, ai ka shprehur mirënjohje edhe për komunën e Skenderajt për organizimin e ceremonisë së varrimit.





KOSOVA NË PAT PASZGJEDHOR: ASNJË DISKUTIM ZYRTAR PËR QEVERINË E RE

Ngërçi paszgjedhor në Kosovë vazhdon, pa asnjë diskutim zyrtar për qeverinë e re. Opozita pranon se bisedime joformale po zhvillohen në prapaskenë, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje këmbëngul se do të qeverisë e vetme

PRISHTINË, 19 MARS - E ardhmja politike e Kosovës mbetet e pasigurt, pasi partitë frenohen të hyjnë në diskutime formale për formimin e qeverisë së re, duke pritur certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit. Në fundjavë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konfirmoi rezultatet përformimtare, të cilat i siguruan Lëvizjes Vetëvendosje - aktualisht në pushtet - një epërsi me 42.30 % të votave. Megjithatë, pa një shumicë të plotë, pyetja mbetet: a do të mund të qeverisë ajo, apo dikush tjetër? Për ta formuar shumicën, Vetëvendosja duhet të sigurojë së paku 61 deputetë në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës. Me rezultatet e konfirmuara i ka 48. “Pasi të certifikohen [rezultatet e zgjedhjeve], do të mund të dimë se si do të arrijmë deri te 61 [deputetët] - edhe me deklarin e partive joserbe dhe joshqiptare, do të thotë të pakicave të tjera”, thotë për

Radion Evropa e Lirë, Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje. Ajo shton se deri më tash nuk ka pasur asnjë konsultim me partitë e tjera politike për formimin e shumicës parlamentare dhe, rrjedhimisht, qeverisë së re. Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve do të bëhet vetëm pasi të përfundojnë procedurat lidhur me ankesat, që i parashtrajnë subjektet politike - garuese në zgjedhje - në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Në këtë panel ka tashmë disa ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës, si dhe koalicioni Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës dhe Lëvizja për Bashkëveprim (PDAK-LPB). Trajtimi i tyre kërkon gjashtë ditë kohë nga PZAP-ja dhe eventualisht gjashtë ditë të tjera nga Gjykata Supreme, në rast se ankesat dërgohen aty. Shumica e ankesave kanë të

bëjnë me votimin me postë dhe disa prej tyre kërkojnë anulimin dhe përsëritjen e tij.

Partitë opozitare, në konsultime joformale

Nga Partia Demokratike e Kosovës, e cila në zgjedhje doli e dyta me 20.95 për qind të votave, nuk iu përgjigjen pyetjeve të Radios Evropa e Lirë rreth konsultimeve të mundshme për formimin e qeverisë së re. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila fitoi 18.27 për qind të votave, thonë se presin certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja për të nisur çfarëdo konsultimi për këtë qëllim. Besian Mustafa nga kjo parti thotë se fillimisht i takon partisë me më së shumti vota - në këtë rast Lëvizjes Vetëvendosje - që ta zgjedhë kryetarin e Kuvendit, në mënyrë që të konstituohet përbërja e këtij institucioni, më pas të tentojë të formojë qeverinë e re. “Deri më tash

LDK-ja nuk është kontaktuar nga Lëvizja Vetëvendosje për këtë çështje”, thotë Mustafa për Radion Evropa e Lirë. Në rast se Lëvizja Vetëvendosje nuk arrin ta formojë qeverinë e re, sipas tij, pritët që mandati për formimin e ekzekutivit të kalojë te partitë opozitare. Por, edhe në këtë kontekst, shton Mustafa, nuk ka pasur konsulta zyrtare me partitë opozitare, porse janë zhvilluar vetëm takime joformale. “Komunikime në mes partive mund të ketë dhe kjo është gjë normale. Zyrtarisht, takime për të diskutuar për formimin e qeverisë nuk kemi pasur... Vetëm pas certifikimit të rezultateve”, thotë Mustafa për Radion Evropa e Lirë. Pas një mbledhjeje të kryesisë më 10 mars, LDK-ja tha se pozicioni i saj është i qartë: “nuk bashkëpunon me partinë në pushtet [LVV]”. Por, edhe në rast të ndonjë koalicioni paszgjedhor të partive opozitare, LDK-ja tha se nuk do të ishte pjesë e ndonjë zgjidhjeje, ku nuk do ta udhëhiqte qeverinë. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila është në koalicion me Nismën Socialdemokrate dhe në zgjedhje fitoi 7.06 për qind të votave, thonë se nuk do të

konsultoheshin fare me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e qeverisë së re. Bekë Berisha nga kjo parti thotë se aktualisht ka konsultime joformale mes partive opozitare. “Nëse qeveria aktuale nuk mund t’i bëjë numrat, atëherë topi është te opozita”, thekson Berisha për Radion Evropa e Lirë. Nisma nuk iu përgjigj kërkesës së REL-it për komente, por kryetari i saj, Fatmir Limaj, ka thënë më herët se nuk ka “vija të kuqe” sa iu përket koalicioneve të mundshme, qoftë me Vetëvendosjen apo partitë e tjera opozitare.

“Partitë po e humbin kohën”

Sociologu dhe analisti politik nga Prishtina, Artan Muhaxhiri, thotë se rezultatet që kanë dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit nuk ia mundësojnë as Lëvizjes Vetëvendosje dhe as tri subjekteve opozitare - PDK-së, LDK-së dhe koalicionit AAK-Nisma - një shumicë të qëndrueshme parlamentare për formimin e qeverisë së re. “Jemi në një ‘pat’ pozicion, që është një sfidë shumë e madhe për kulturën dhe inteligjencën politike, si dhe për vetëdijen e

BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES NË MES TË KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE KROACISË NERVOZON SERBINË

PRISHTINË, 19 MARS - Kosova, Shqipëria dhe Kroacia më 18 mars nënshkruan një deklaratë në Tiranë, përmes së cilës vendet angazhohen ta forcojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zhvillim që ka nxitur reagime në Serbi, që e cilësoi si “provokim të hapur” drejtuar Beogradit.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, e nënshkroi këtë deklaratë së bashku me homologun nga Shqipëria, Pirro Vengu dhe atë kroat, Ivan Anushiq. “Duke u bazuar në vlerat tona të përbashkëta, në orientimet e njëjta gjeostrategjike dhe në angazhimet e ndërsjella për bashkëpunim rajonal, Shqipëria, Kroacia dhe Kosova angazhohen për forcimin e bashkëpunimit dhe avancimin e hapave për mbrojtjen e territoreve dhe popujve tanë, për të kontribuar në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, si dhe në zhvillimin e industrisë së mbrojtjes”, tha Maqedonci pas nënshkrimit të deklaratës. Sipas tij, të tri shtetet do të punojnë që të rrisin ndërveprueshmërinë mes ushtrive përmes edukimit,

trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta, do të angazhohen që të luftojnë kërcënimet hibride si dhe do t'i koordinojnë politikat për integritet euroatlantike. “Ky bashkëpunim nuk është kërcënim për askënd, por një angazhim shtesë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Bashkë me Shqipërinë dhe Kroacinë, Kosova është më e fortë, rajoni më i sigurt dhe paqja më e qëndrueshme”, tha Maqedonci. Shqipëria dhe Kroacia janë vende anëtare të NATO-s, organizatë ku Kosova synon që një ditë të anëtarësohet.

Nënshkrimi i deklaratës vjen në kohën kur Kosova po vazhdon procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri dhe disa ditë pasi Maqedonci shpalosi detaje të një nisme për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes me Shteteve të Bashkuara.

Qeveria e Kosovës ka miratuar në parim nismën për lidhjen e një marrëveshjeje kornizë për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes në mes të Kosovës dhe Shteteve të

Bashkuara. Ai tha se Uashingtoni do ta ndihmojë Prishtinën në ngritjen e kapaciteteve strategjike ushtarake.

Ministri shqiptar i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e cilësoi deklaratën hap të rëndësishëm drejt forcimit të aftësive mbrojtëse, zhvillimit të industrisë dhe teknologjisë së mbrojtjes, si dhe përmirësimit të ndërveprimit ushtarak në rajon. “Shqipëria dhe Kroacia do të vijnë ta mbështesin Kosovën në aspiratën e saj për integritet të plotë në strukturat rajonale dhe euroatlantike”, shkroi ai në X. Ndërkaq, ministri kroat i Mbrojtjes, Ivan Anushiq, pas nënshkrimit të deklaratës në Tiranë, tha se duke parë rreziqet gjeopolitike të sigurisë në Evropën Juglindore, shteti i tij është i vendosur t'i forcojë raportet me Shqipërinë dhe Kosovën.

Ai tha se Kroacia, si anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, ka njohuri të çmuara dhe dëshiron t'i ndajë me aleatët. “Me këtë nismë, që do të përfshijë edhe shtete të tjera të interesuara nga Evropa Juglindore, ne forcojmë pozicionin tonë brenda

NATO-s dhe BE-së dhe kontribuojmë për një rajon më të qëndrueshëm dhe më të sigurt”, tha ai.

Serbia kërkon shpjegim nga Kroacia dhe Shqipëria

Pas kësaj deklarate trepalëshe të bashkëpunimit, Ministria serbe për Punë të Jashtme tha se do të kërkojë urgjentisht shpjegime nga ministria e Jashtme e Shqipërisë dhe nga ajo e Kroacisë. Sipas Beogradit, Shqipëria dhe Kroacia me nënshkrimin e këtij dokumenti “ndërmorën hapa që minojnë stabilitetin rajonal”.

Autoritetet në Beograd, që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës, thanë se kjo nismë paraqet “provokim të hapur dhe shpërfillje të madhe të realitetit në terren”. “Ne presim përgjigje urgjente nga Zagrebi dhe Tirana për qëllimet e vërteta të kësaj loje të rrezikshme të sigurisë. Serbia nuk do të lejojë veprime të njëanshme që mund ta rrezikojnë integritetin tonë territorial, sigurinë e qytetarëve dhe paqen në rajon”, u tha në reagimin e Ministrisë së Jashtme të Serbisë.

Sipas Serbisë, deklarata e bashkëpunimit ishte rezultat i “një strategjie që synon izolimin e Serbisë”.

Kosova dhe Serbia më 2023 palët arritën një marrëveshje për rrugën drejt normalizimit, e cila, veç të tjerash, i kërkon Serbisë të mos pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Tensionet mes dy shteteve kanë qenë të larta vitet e fundit, me Kosovën që e ka fajësuar Serbinë se qëndron prapa sulmeve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Kosova fajëson Serbinë për sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit më 2023, ku u vra një polic. Gjatë këmbimit të zjarrit me grupin e armatosur serbë, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Prishtina e ka fajësuar Beogradin edhe për një shpërthim në kanal in e Ibër Lepencit në veriun e Kosovës nëntorin e vitit 2024. Ky kanal furnizon me ujë disa rajone të Kosovës dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termoelektranave të saj. Serbia ka mohuar vazhdimisht akuzat e Kosovës.



liderëve që ta gjejnë një rrugëdalje nga kjo bllokadë”, thotë Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, subjektet politike nuk kanë ende ndonjë vizion të qartë se si do të arrijnë deri te qeveria e re.

Ai shpreh habinë sesi partitë politike nuk kanë nisur deri më tash konsultimet zyrtare për këtë qëllim sepse, siç thotë, certifikimi i rezultateve nga KQZ-ja nuk do të mund të sjellë ndryshime që do t'i ndikonin përqindjet e fituara të votave

nga partitë politike. “Nuk ka asnjë mundësi që të ndryshojnë raportet ndërmjet partive politike. Prandaj, çdo vonesë është humbje e madhe e kohës”, thotë Muhaxhiri. Sipas tij, Lëvizja Vetëvendosje mund ta krijojë shumicën parlamentare dhe më pas edhe qeverinë, vetëm nëse arrin të sigurojë dhjetë votat e komuniteteve joserbe, si dhe tri vota nga Nisma.

Përfaqësuesit e komuniteteve joserbe kanë thënë më herët

për REL-in se, parimisht, do të mbështesnin cilindo mandatar për formimin e qeverisë së re.

Çfarë ndodh pas certifikimit të rezultateve?

Pas certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, brenda 30 ditësh, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duhet ta thërrasë mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës, e cila do të

konsiderohet e mbyllur vetëm pasi të zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Presidentja e vendit obligohet ta nominojë partinë fituese të zgjedhjeve si mandatare për formimin e qeverisë dhe procesi duhet të zhvillohet “sa më parë që të jetë e mundur”. Kabineti qeveritar i propozuar duhet t'i sigurojë votat e 61 deputetëve.

Në rast se dështon, atëherë presidentja është e obliguar që brenda dhjetë ditësh t'i ftojë në

konsultim edhe një herë partitë politike, edhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë. Mandatarja e ardhshme duhet t'i ketë 15 ditë kohë që t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar.

Nëse qeveria nuk formohet pas 40 ditësh, presidentja duhet ta shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen 40 ditë prej shpalljes së vendimit.

GJYKATA SPECIALE NË HAGË, DREJTËSI APO MEKANIZËM POLITIK?



Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

1. Një Gjykatë që thirret në emër të Kosovës, por vepron kundër interesave të saj

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, e njohur si Gjykata Speciale, u krijua si rezultat i presionit ndërkombëtar, veçanërisht nga Bashkimi Evropian, me pretekstin e hetimit të krimeve të supozuara të kryera nga pjesëtarët e UÇK-së gjatë dhe pas luftës së Kosovës (1998-2000).

Ajo u themelua përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të miratuara nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015, pas kërcënimeve të BE-së se nëse Kosova nuk do ta pranonte këtë gjykatë, atëherë rasti do të kalonte në një tribunal ndërkombëtar jashtë juridiksionit të Kosovës. Kjo do të thoshte se Kosova nuk do të kishte asnjë ndikim mbi të, edhe formalisht.

Problemi kryesor me këtë gjykatë është fakti se, megjithëse ligjërisht është pjesë e sistemit të Kosovës, ajo operon jashtë çdo kontrolli nga institucionet e vendit, me gjyqtarë, prokurorë

dhe staf të huaj, duke bërë që ajo të duket më shumë si një mekanizëm i imponuar politik sesa një gjykatë që synon të vendosë drejtësi në mënyrë të paanshme.

2. Qëllimi i Gjykatës Speciale: Drejtësi apo ndëshkim politik?

Ndryshe nga gjykatat e tjera ndërkombëtare ose të përziera që kanë pasur një objektiv më të gjerë për të hetuar të gjitha palët e përfshira në një konflikt, Gjykata Speciale është e vetmja në botë që heton ekskluzivisht një anë të një lufte çlirimtare.

Kjo qasje e njëanshme e bën këtë gjykatë një mjet ndëshkimi politik për luftëtarët e UÇK-së dhe, për pasojë, për vetë Kosovën.

Një nga argumentet më të fuqishme kundër kësaj gjykate është mungesa e hetimeve për krimet serbe në Kosovë, edhe pse këto krime janë të dokumentuara nga organizata ndërkombëtare, përfshirë: Raportet e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë (ICTY), që konfirmojnë se forcat serbe kryen krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë. Raportet e organizatave si Human Rights Watch, Amnesty International dhe Komisioni Evropian, të cilat kanë listuar qindra raste të masakrave të popullsisë civile shqiptare nga ushtria dhe policia serbe. Pavarësisht këtyre provave, Gjykata Speciale nuk ka trajtuar asnjë nga këto raste. A nuk është ky një tregues i qartë i misionit të saj të njëanshëm?

3. Raste konkrete të dënimeve të njëanshme nga Gjykata Speciale

3.1. Rasti i Hashim Thaçit, Kadri Veselit etj., Drejtësi apo hakmarrje politike?

Në nëntor 2020, Hashim Thaçi, ish-presidenti i Kosovës dhe një nga udhëheqësit kryesorë të UÇK-së, së bashku me Kadri Veselin, ish-kryetar i Kuvendit dhe ish-shef i SHIK-ut, u arrestuan nga Gjykata Speciale nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Problemet kyçe me këtë rast: Akuzat bazohen kryesisht në dëshmi të mbledhura nga raporti i Dick Martyt, i cili nuk ka asnjë provë të drejtpërdrejtë për akuzat e pretenduara.

Shumë dëshmitarë janë identifikuar si të manipuluar ose të ndikuar politikisht, duke ngritur pikëpyetje mbi integritetin e procesit.

Ndërkohë që Thaçi dhe Veseli etj, mbahen në paraburgim pa një vendim gjyqësor të qartë, kriminelët serbë të luftës janë liruar ose nuk janë hetuar fare.

3.2. Rasti i Salih Mustafës (Komandant Cali) - Dënim i njëanshëm dhe pa prova të forta. Salih Mustafa, një ish-komandant i UÇK-së, u dënua nga Gjykata Speciale në dhjetor 2022 me 26 vjet burgim. Ky është një rastet më të kontestuara, pasi: Akuzat u bazuan në dëshmi të individëve të cilët nuk ishin verifikuar në mënyrë të pavarur. Procesi i gjykitimit kishte shumë probleme me procedurat dhe mbrojtjen ligjore, duke lënë hapësirë për dyshime mbi

drejtësinë e vendimit.

Ndërkohë, asnjë nga autorët e masakrave në Reçak, Izbicë, Krushë të Madhe dhe shumë të tjera nuk është përballur me drejtësinë ndërkombëtare.

4. Pse Gjykata Speciale nuk merret me krimet serbe?

Për të kuptuar qartë pse kjo gjykatë nuk heton krimet e Serbisë, duhet të shikojmë ndikimin politik dhe gjeopolitik: Serbia ka përkrahje të fortë nga Rusia dhe disa shtete të BE-së, të cilat nuk duan që Beogradi të ndëshkohet për krimet e saj, pasi kjo do të hapte një precedent për gjykimet e mëvonshme.

Lobimi serb ka qenë shumë aktiv në BE dhe SHBA, duke bërë që narrativa të anojë drejt barazimit të krimeve, edhe pse realiteti është shumë ndryshe.

Kosova nuk ka pasur strategji të fuqishme diplomatike për të kërkuar barazi në proceset gjyqësore ndërkombëtare, duke lejuar që kjo gjykatë të bëhet një instrument ndëshkues ndaj

UÇK-së.

5. Konkluzioni: Gjykata Speciale si mekanizëm i pabarazisë ndërkombëtare

Nëse Gjykata Speciale do të kishte një mandat të drejtë dhe të barabartë, ajo do të duhej të merrej me të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, përfshirë ato të Serbisë. Megjithatë, ajo është krijuar dhe funksionon si një mjet politik për të ndëshkuar vetëm njërën palë, duke dëmtuar legjitimitetin e luftës çlirimtare dhe duke përçuar mesazhin se Kosova është një shtet i kriminalizuar.

Kjo qasje është jo vetëm e padrejtë, por edhe e rrezikshme, pasi krijon një precedent negativ për drejtësinë ndërkombëtare, ku viktima e një lufte kthehet në fajtor ndërsa agresori mbetet i paprekur. Për sa kohë që kjo gjykatë nuk vepron mbi bazën e parimeve të një drejtësie të barabartë dhe të paanshme, ajo do të mbetet një simbol i padrejtësisë dhe instrumentalizimit politik të ligjit ndërkombëtar.



POLICIA E KOSOVËS I ARRESTON 16 TË DYSHUAR PËR KONTRABANDË ME ARMË, PËRFSHIRË NJË ZYRTAR POLICOR

PRISHTINË, 19 MARS - Policia e Kosovës i ka arrestuar 16 të dyshuar, përfshirë një zyrtar policor, për kontrabandë me armë të mërkurën gjatë një operacioni të gjerë policor në jug dhe veri të Kosovës.

Në një komunikatë të përbashkët, Policia e Kosovës dhe Prokuroria Themelore e Mitrovicës njoftuan se operacioni policor u krye në 21 lokacione në Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut, Vushtrri, Skenderaj dhe Leposaviq. Gjatë operacionit janë sekuestruar nëntë armë zjarri, 200 fishekë, municione të ndryshme, 15 telefona mobilë, dy palë pranga, thikë, tyta të armës, fatrolla për armë dhe një DVR, thuhet në njoftim.

Operacioni vjen pas hetimeve disamujore dhe u krye nga Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me mbështetjen e njësie



policore dhe Inspektoratit Policor të Kosovës.

Të arrestuarit dyshohen për kryerjen e veprave penale "detyrim", si dhe "importim,

eksportim, furnizim, transportim, prodhim, këmbim, ndërmjetësimi ose shitje të paautorizuar të armëve apo materieve plasëse". Zëvendës drejtori i Policisë së

Kosovës për veriun, Veton Elshani, tha për Radion Evropa e Lirë (REL) se në mesin e të arrestuarve është dhe një zyrtar policor, i cili është pezulluar gjatë

arrestimit. "Polici është pezulluar përkohësisht gjatë arrestimit, deri në përfundimin e hetimeve. Nëse është i pafajshëm, do të kthehet në punë", ka thënë Elshani, duke mos dhënë më shumë hollësi.

REL-i mëson nga burimet e saj se polici i arrestuar është nga radhët e komunitetit serb.

Trembëdhjetë nga 16 të arrestuarit janë dërguar në paraburgim për 48 orë, thuhet në njoftim.

Identiteti i të dyshuarve të tjerë nuk është bërë me dije.

Autoritetet e sigurisë nuk dhanë më shumë hollësi në lidhje me atë se nga cilat vende apo se në cilat vendet mund të kenë importuar dhe eksportuar armë të dyshuarit. Në të kaluarën Policia e Kosovës ka gjetur dhe konfiskuar armatim kohë pas kohe, veçanërisht në veri të vendit.

IKShPK-ja zhvillon trajnim në Laboratorin Referent Nacional për Diagnostikë të Tuberkulozit

PRISHTINË, 19 MARS - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) vazhdon përkushtimin për avancimin e kapaciteteve laboratorike në diagnostikën e tuberkulozit.

Nga 24 shkurt deri më 21 mars 2025, në Laboratorin Nacional Referent për Diagnostikë të Tuberkulozit (NRL/TB) është duke u mbajtur një trajnim

intensiv për përmirësimin e aftësive laboratorike në testimin e Mycobacterium tuberculosis. Trajnues janë: Ass. dr. Sci. Rrezarta Bajrami Halili - Udhëheqëse e NRL/TB, IKShPK; Xhevat Shkodra - Laborant, NRL/TB, IKShPK; Shukrane Shehu - Laborante, NRL/TB, IKShPK.

Ndërkaq pjesëmarrës: Alban Lajqi - laborant në trajnim,

Spitali i Pejës.

Qëllimi i trajnimit është rritja e aftësive laboratorike për diagnostikën e tuberkulozit dhe përmirësimi i cilësisë së analizave dhe biosigurisë në laborator.

Aftësitë e fituara do të jenë përpunimi i mostrave për kulturë dhe analiza laboratorike, kryerja e baciloskopisë me metodën Ziehl-Neelsen,

përdorimi i GenExpert për diagnostikim të shpejtë dhe ndjeshmëri ndaj Rifampicinës dhe zbatimi i masave të biosigurisë në laborator.

IKShPK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar për përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe laboratorike për një diagnostikim të saktë dhe efikas të tuberkulozit në Kosovë.



KGJK-ja mirëpret opinionet e Komisionit të Venecias për reformën në drejtësi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 MARS - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka mirëpritur opinionet e Komisionit të Venecias për projektligjet që kanë të bëjnë me KGJK-në, me rekrutimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me procedurën disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë dhe Akademinë e Drejtësisë. Këto opinione janë miratuar gjatë Sesionit të 142-të Plenar të Komisionit më 14-15 mars 2025.

Në një komunikatë për medie, KGJK vlerësoi analizën e Komisionit të Venecias për pakon legjislative, duke theksuar se "projektligjet janë përgjithësisht në harmoni me standardet evropiane".

Këshilli nënvizon se rekomandimet e Komisionit

janë të "mirëseardhura" dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e pavarësisë, efikasitetit dhe integritetit të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Projektligjet, të cilat janë rezultat i një angazhimi të përbashkët për reformën në drejtësi, janë nënshkruar më 14 mars 2023 nga Ministria e Drejtësisë, KGJK, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Gjykata Supreme dhe Prokurori i Shtetit.

KGJK ka shprehur angazhimin për ta përmbyllur procesin e miratimit të këtyre projektligjeve në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Në lidhje me rekomandimet, KGJK ka theksuar disa pika kyçe që do të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, duke



përfshirë: Sigurimin e pavarësisë institucionale të KGJK-së dhe shmangien e çdo ndikimi të panevojshëm nga ekzekutivi apo organet e tjera të pushtetit; Përmirësimin e procedurave të rekrutimit, emërimit dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duke siguruar standarde të qarta dhe të parashikueshme;

Sigurimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe të drejtë të kontrollit të integritetit dhe disiplinës në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet evropiane si dhe Garantimin e trajnimeve cilësore për gjyqtarët.

KGJK, gjithashtu, ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e kësaj pakoje

ligjore, përfshirë gjyqtarët, ekspertët, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile. "Kontributi i tyre ka qenë i një rëndësie të veçantë për sigurimin e një reforme gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në standarde të larta profesionale", theksohet në njoftimin e KGJK-së.

Në përmbyllje, KGJK ka bërë thirrje për adresimin sa më të shpejtë të rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe ka theksuar rëndësinë e përparimit të reformës në drejtësi, si një element kyç në rrugën e Kosovës drejt integritetit evropian. "Progresi në zbatimin e kësaj reforme është thelbësor për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të besueshëm, transparent dhe efikas, që u shërben qytetarëve dhe rrit besimin e publikut në drejtësi", thuhet në komunikatën për medie.

Eurodeputeti Mandl të premten diskuton në UP për sfidat dhe të ardhmen e Kosovës

PRISHTINË, 19 MARS - Deputeti austriak në Parlamentin Evropian, Lukas Mandl, të premten e 28 marsit do të takohet me rektorin e UP-së, Arben Hajrullahu dhe prej orës 12 e 30, për një orë do të diskutojë me të pranishmit në sallën e Senatit të Universitetit të Prishtinës rreth Kosovës dhe integritetit të saj në BE, sfidave dhe perspektivës.

Miku i madh dhe i dëshmuar i Kosovës, që është anëtar i Grupit të Partive Popullore Evropiane



në Parlamentin Evropian që nga viti 2017, në vitin 2021 publikoi

librin "Kosova dhe BE-ja - Gjendja aktuale", në të cilin

qëndrimet e tyre i shfaqën një numër i madh i personaliteteve evropiane dhe kosovare të fushave të ndryshme. Libri atëherë u botua në katër gjuhë: Shqip, serbisht, anglisht e gjermanisht.

Në përvjetorin e 17 të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, presidentja Osmani e nderoi eurodeputetin Lukas Mandl, me "Medaljen Presidenciale të Meritave", për të mos harruar ata që "kuptuan dhimbjen tonë, dëgjuan zërin tonë dhe

ndihmuan të drejtën tonë për liri".

Mandl ishte një nga themeluesit e Shoqatës së Miqësisë Kosovë - Austri që aktualisht drejtohet nga Arbër Marku.

Përveç në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, për sfidat dhe perspektivën e integritetit evropian të Kosovës, Mandl do të diskutojë edhe në Universitetin e Gjilanit "Kadri Zeka". Ky universitet eurodeputetin austriak e shpalli "Doktor Nderi" në vitin 2023.

Clintoni u nderua me çmimin "Paqebërësi i Shekullit", Osmani: Mbështetja e tij për Kosovën ka qenë gjithmonë pasqyrim i vlerave amerikane

PRISHTINË, 19 MARS - Në Berlin presidentja Vjosa Osmani ka pasur nderin ta lexojë një 'Laudatio' për ish-presidentin e ShBA-së, Bill Clinton, i cili u nderua me çmimin "Paqebërësi i Shekullit" nga "World Forum".

Osmani ka thënë se teksa qëndronte para tij, kujtoi marsin e vitit 1999, kur dëgjonin me shpresë fjalimet e

tij në një radio të vogël, ndërsa populli i Kosovës përjetonte tmerrin e regjimit të Millosheviqit. "Sot, falë luftës çlirimtare dhe falë leadershipit të botës demokratike dhe mbështetjes bipartizane amerikane, si nga demokratët ashtu edhe republikanët, Kosova frymon e lirë dhe e pavarur. Mbështetja e presidentit Clinton për Kosovën ka qenë gjithmonë

pasqyrim i vlerave amerikane - të lirisë, drejtësisë dhe demokracisë. Faleminderit, president Clinton, jo vetëm për marrëveshjet e nënshkruara, por mbi të gjitha për jetët e shpëtuar. Dhe në veçanti, faleminderit në emër të fëmijëve të tashëm të Kosovës - brezi i parë që nuk po rritet në luftë e që njeh vetëm paqe", ka theksuar Osmani.



Qytetarët nuk mund t'i përballojnë çmimet e larta

PRISHTINË, 19 MARS - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar një anketë mbi përballueshmërinë e familjeve të Kosovës në kushtet aktuale ekonomike dhe rritjen e çmimeve. Sipas rezultateve, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka vështirësi në përballimin e shpenzimeve të përditshme.

Kështu janë deklaruar qytetarët: Sa e kanë të vështirë familjet e Kosovës t'i paguajnë shpenzimet e zakonshme? Me vështirësi të mëdha: 5.4 %; Me vështirësi: 15.3 %; Me disa vështirësi: 44.1 %; Mjaft lehtë: 14.2 %; Lehtë: 19.9 %; Shumë lehtë: 1.1 %.

A mund t'i përballojnë familjet e Kosovës një shpenzim të

papritur prej 200 eurosh? Po: 44.3 % dhe Jo: 55.7 %. A mund të përballojnë një vakt me mish ose peshk çdo dy ditë? Po: 63 % dhe Jo: 36.5 %. Megjithatë, përballueshmëria bëhet edhe më e vështirë kur bëhet fjalë për investime afatgjata, si blerja e mjeteve shtëpiake apo ngrohja e shtëpisë gjatë dimrit.



“Protestat do të jenë të vazhdueshme”, kundërshtohet fuqishëm shtrenjtimi i rrymës

PRISHTINË, 19 MARS - Qytetarët kanë reaguar ashpër ndaj propozimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për rritjen e tarifave të rrymës me 15 për qind. Një numër i madh i tyre iu bashkua iniciativës së organizatorit Luan Hasanaj, i cili ka nisur një kundërshtim publik përmes grupit “Jo rritjes së çmimit të energjisë elektrike në Kosovë! #AsnjëCentMëShumë”, i krijuar menjëherë pas publikimit të lajmit për shtrenjtimin e rrymës. Hasanaj, në një intervistë për emisionin “Ora Shtatë” në Klan Kosova, ka bërë me dije se vetëm brenda dy ditësh grupi ka mbledhur mbi 1 000 persona dhe shtoi se protesta nuk do të ndalet me kaq. “Nëse shohim se nuk do të ketë reflektim, sigurisht se është e



pashmangshme një proteste sa më e madhe për kundërshtimin e këtij shtrenjtimi”, u shpreh ai. Ndërkaq KMDLNJ në lidhje me këtë temë ka theksuar se nëse dikush i ka dëmtuar më së

shumti qytetarët dhe bizneset e Kosovës dhe nuk është dënuar janë piratët grabitës të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE), që nga paslufta e sidomos sot. “Qeveria Kurti 1

dhe 2 deti më tani i ka rritur faturat e rrymës mbi 130 për qind, kurse po kjo qeveri po e shfrytëzon një vakum të krijuar duke e lejuar strukturën zhvatëse ZRrE ta rrisë rrymën

së paku për 15 për qind shtesë. Para zgjedhjeve Qeveria e Kosovës thoshte se rryma nuk do të shtrenjtohet, që ishte deklarata politike mashtruese, kurse ZRrE-ja deklaronte se nuk do të ketë rritje të faturave të rrymës e që ishte vetëm alibi për krimin e radhës ekonomik dhe social. Po kjo ZRrE-ja, thuaja për 15 vjet i ka vjedhur qytetarët shqiptarë dhe joserbë duke ua fryrë faturat për ta kompensuar rrymën e papaguar nga serbët e veriut dhe vendeve të tjera në Kosovë”, është thënë në reagimin e KMDLNJ-së, duke theksuar se në vazhdimësi ka kundërshtuar veprimet e ZRrE-së dhe qeverive mandatore për shpërdorim të çmimeve të rrymës që, sipas KMDLNJ-së, janë në shpërputhje të madhe me mundësitë materiale të qytetarëve të Kosovës.

Gërxxhaliu: Shqetësuese, rënia e eksporteve ‘Made in Kosova’

PRISHTINË, 19 MARS - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxxhaliu, ka thënë se ekonomia e Kosovës edhe më tutje vazhdon të mbetet nën dominimin e agjendës politike. Ai ka thënë se numërimi i tejzgatur i votave dhe vonesa në epilogun e zgjedhjeve po krijojnë stagnim në proceset shtetërore, në veçanti në ato ekonomike. “Mungesa e investimeve të huaja është shqetësuese për të ardhmen ekonomike të Kosovës. Procesi gjyqësor me ish-krerët e UÇK-së dhe shtetit, sanksionet ekonomike të BE-së ndaj Kosovës, raportet e zbehura me



aleatët strategjikë si ShBA-ja dhe vendet evropiane, si dhe mungesa e stabilitetit politik, që lidhet kryesisht me dialogun me Serbinë, janë arsye shqetësuese

për të ardhmen ekonomike të Kosovës dhe për investimet e huaja. Mungesa e një diplomacie aktive të Kosovës, në veçanti asaj ekonomike, po

dëmton edhe më shumë imazhin e vendit”, ka thënë Gërxxhaliu. Ai ka theksuar se ka filluar një rend i ri botëror, “Trampizmi” dhe, si duket, Kosova nuk po e kupton nevojën dhe arsyen për reflektim dhe ndryshim të qasjes. “Është shqetësuese situata në sektorin privat, në veçanti në atë prodhues, ku bilanci tregtar dymujor për vitin 2025 është 120.65 milionë euro eksporte dhe 985.76 milionë euro importe. Gjithashtu, shqetësuese është situata në sektorin e energjisë elektrike, ku ka paralajmërime për ngritje të çmimit për 15 %, që do të jetë një

goditje e rëndë për sektorin, në veçanti për atë prodhues. Tentativa për tregun e lirë të energjisë për biznese do të jetë një barrë shtesë sepse, krahas çmimit të lartë të energjisë elektrike, transporti i saj do ta rrisë koston dhe do të ndikojë në mënyrë zinxhirore edhe në çmimin e produkteve vendore, duke ulur konkurrueshmërinë në tregjet rajonale dhe më gjerë”, është shprehur ai. Gërxxhaliu ka thënë se partneriteti me sektorin privat dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm duhet të jetë prioritet i prioritetëve për çdo qeveri që do të themelohet në të ardhmen.

Hekurudha Shkodër - Gjakovë me 7 stacione dhe 43 ura, vlera e projektit pritet të jetë rreth 2 miliardë

PRISHTINË, 19 MARS - Kryetari i Bashkisë së Shkodrës, Benet Beci, ka dhënë hollësi rreth ndërtimit të linjës hekurudhore Shkodër - Gjakovë, projekt ky strategjik infrastrukturor që synon t'i forcojë lidhjet ndërmjet

Shqipërisë dhe Kosovës. “Hekurudha Shkodër - Gjakovë do të ketë 7 stacione dhe një gjatësi prej 105.8 km. Ky investim strategjik infrastrukturor do të përfshijë 43 ura dhe 14 tunele, me një gjatësi totale tunelesh prej 35.3

km. Sipas ekspertëve dhe studimit të fizibilitetit tashmë të realizuar, kostoja e këtij segmenti përlllogaritet në 1.8 miliardë euro. Nga kjo shumë, rreth 1.7 miliardë euro janë të nevojshme për ndërtimin, ndërsa pjesa tjetër përfshin

kosto për leje, shpronësime dhe detaje të tjera teknike”, ka shkruar ai në “Facebook”. Sipas tij, ky investim rikthen në vëmendje historinë e Shkodrës dhe lidhjen e saj shekullore me Gjakovën përmes hekurudhës.



‘MOSKA DO TË MARRË ATË QË DËSHIRON, PA LËSHIME. PËR TRUMPIN, UKRAINA I PËRKET KREMLINIT’

Politologu Yascha Mounk: "Për Uashingtonin, bota ndahet në sfera influence; ata që e ndajnë atë janë SHBA, Rusia dhe Kina"



Telefonata midis Donald Trump dhe Vladimir Putin sapo ka përfunduar. Një telefonatë nga e cila mund të varet jo vetëm e ardhmja e luftës në Ukrainë, por edhe, në një farë mënyre, e ardhmja e gjithë Evropës. Yascha Mounk – politolog, një nga studiuesit kryesorë të krizës së demokracisë liberale dhe të ngritjes së populizmit – ditët e fundit ishte shprehur i shqetësuar për atë që parashikohet të ishte një marrëveshje, ku Ukraina kishte gjithçka për të humbur dhe Rusia gjithçka për të fituar. Pas përfundimit të telefonatës, ai nuk është i habitur. “Kanë kaluar muaj që situata duket se po shkon në këtë drejtim, me Ukrainën që do të detyrohet të pranojë humbjen e një pjese të territorit të saj sovran. Prej kohësh është bërë e qartë se ajo nuk është në gjendje ta dëbojë ushtrinë ruse nga territori i saj, dhe për këtë arsye, në një farë mënyre, një formë ndërprerjeje e luftimeve është e nevojshme. Problemi është se, edhe nëse ky realitet ekziston, do të kishim pasur nevojë për një kusht për të arritur një paqe, në mos të drejtë, të paktën sa më pak të padrejtë.”

Cili është ky kusht?



“Vazhdimi i mbështetjes publike dhe ushtarake nga Shtetet e Bashkuara dhe Evropa, në mënyrë që ta detyronin Putinin të bënte lëshime të vërteta. Frika në këtë moment nuk është armëpushimi, të cilin të gjithë e dëshirojmë, por që do të pranohet që një pjesë e territorit ukrainas të mbetet nën kontrollin e Rusisë dhe që nga Rusia nuk do të kërkohet asgjë në këmbim. Këto dy gjëra, edhe nëse sjellin paqe, nuk do të sjellin një paqe të qëndrueshme, duke marrë parasysh synimet ekspansioniste të Putinit.” A del Putini i rehabilituar dhe i forcuar nga kjo telefonatë me Trumpin? “Skandali nuk është që Trumpi flet me Putinin, por mënyra se si flet për të. Trumpi flet për ‘ndarjen e aseteve ukrainase.’ Kjo është një gjuhë biznesi, më shumë sesa diplomaci. Ka edhe një kontradiktë në atë që unë e quaj instinktin e tij të dyfishtë në politikën e jashtme: ai flet në mënyrë shumë agresive kur

bëhet fjalë për Panamanë, Kanadanë, Grenlandën – vende për të cilat duket se ka ambicie ekspansioniste. Nga ana tjetër, kur flet për Ukrainën, por edhe për Tajvanin dhe territore të tjera, ai duket sikur po thotë se interesat e Shteteve të Bashkuara nuk janë të zgjerohen, por përkundrazi, të lënë kontrollin mbi këto territore tek fuqitë historikisht armiqësore ndaj SHBA. Në të vërtetë, sipas meje, ka një shpjegim për këtë paradoks të dukshëm: Trump e sheh botën të ndarë sipas sferave të influencës. Ai beson se Ukraina bën pjesë në sferën natyrore të influencës së Rusisë, se Tajvani bën pjesë në sferën natyrore të influencës së Kinës, dhe se Grenlanda ose Panamaja duhet të jenë pjesë e sferës natyrore të influencës së Shteteve të Bashkuara. E gjithë kjo e shoqëruar me një qasje oportuniste, sipas së cilës objektivi është të përfitohet sa më shumë nga ato zona që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të SHBA-së, dhe të braktisen të tjerat ndaj Rusisë apo Kinës, me një indiferencë të plotë ndaj rendit të mëparshëm botëror.”

Në këtë kontekst, si e sheh Trumpi Evropën?

“Ajo është një aleat, por ka më shumë ose më pak rëndësi në varësi të asaj se sa i shërben interesave amerikane. Evropa Lindore është në rregull të mbetet nën ndikimin e Rusisë, dhe për këtë arsye nuk mbrohet; Evropa Perëndimore është më mirë të mbetet në sferën e influencës së Shteteve të Bashkuara, por në kushte shumë më pak të favorshme sesa më parë. Në këtë kontekst të ri botëror, Evropa duhet të vendosë se çfarë të bëjë: nëse dëshiron të jetë një entitet, fati i të cilit përcaktohet nga politikanë apo diktatorë të largët, apo nëse dëshiron të bëhet zonjë e fatit të saj. Dhe nëse dëshiron të marrë në dorë të ardhmen e saj, atëherë duhet të ndryshojë shumë, jo vetëm të shpenzojë më shumë për mbrojtjen, por edhe të bëhet sërish një forcë e vërtetë ekonomike në botë, që do të thotë të prodhojë avionë modernë, të ketë automjete elektronike konkurruese, të jetë në pararojë të kërkimit mbi

inteligjencën artificiale. Për shumë kohë, Evropa ka menduar se mund të ndjekë një model si ai italian, një rënie e ngadaltë, por mjaft komode. Në këtë realitet të ri botëror, më duket se kjo mundësi nuk ekziston më.” Ursula von der Leyen thotë se nëse Evropa dëshiron paqe, duhet të përgatitet për luftë. “Historia e 20 viteve të fundit na ka treguar se Putini e sheh çdo formë dobësie si një provokim. Ai e ka parë mundësinë e zgjerimit të territorit të tij me Gjeorgjinë dhe Ukrainën – dhe me vende të tjera – si një ftesë për të nisur një luftë dhe për të realizuar qëllimin e tij të vërtetë: zhbërjen e asaj, që ai e konsideron si tragjedinë më të madhe gjeopolitike të shekullit XX – shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. Unë besoj se mënyra më e mirë për t’u mbrojtur kundër rrezikut të zgjerimit rus është të kesh një forcë të besueshme penguese, por për ta realizuar këtë, duhet të jesh edhe i aftë të mbrohesh. Askush në Evropë nuk dëshiron luftë, por ndonjëherë mënyra më e mirë për ta shmangur luftën është të dish të mbrohesh.” / La Stampa – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova luan sot për fitore ndaj Islandës

Prishtinë, 19 mars - Kombëtarja e Kosovës dhe ajo e Islandës do të ballafaqohen sot (e enjte) në Prishtinë në duelin e parë të “play-off”-it të Ligës së Kombeve, kurse

ndeshja e dytë do të luhet të dielën në Murcia të Spanjës. Të dyja ekipet tashmë i kanë bërë të gjitha përgatitjet dhe kanë shprehur optimizëm për rezultat pozitiv, veçanërisht

Kosova, e cila në këtë takim hyn për fitore. Ekipi që do të tregohet më i suksesshëm në këto dy sfida do të luajë në Ligën B të Ligës së Kombeve në edicionin e ardhshëm,

kurse ekipi tjetër do të përfundojë në Ligën C. Ndeshja Kosova - Islanda luhet në stadiumin “Fadil Vokrri” duke filluar nga ora 20:45.



Pezullohet tenderi për rinovimin e stadiumit të Gjilanit



Prishtinë, 19 mars - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MRKS) i ka pezulluar procedurat e prokurimit për projektin e ndërtimit dhe rinovimit të Stadiumit të Gjilanit. Kjo gjë ka ndodhur pak ditë pasi është shpallur kompania fituese me ofertën mbi 12.7 milionë euro. Ky vendim ka ardhur si rezultat i disa kërkesave për rishqyrtim të paraqitura nga operatorë ekonomikë të pakënaqur me procesin e tenderimit. Sipas Zyrës së Prokurimit të MKRS-së, pezullimi ka ndodhur në përputhje me Ligjin për

Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i cili ka parashikuar ndalimin e mëtejshme të aktiviteteve të prokurimit në raste kur ka ankesa nga operatorët pjesëmarrës në garë. Më tutje, MKRS-ja ka treguar se autoritetet do t'i informojnë palët e interesuara për çdo vendim të ardhshëm. Procesi mund të vazhdojë nëse ankesat refuzohen, por mund të ketë rishpallje të tenderit ose ndryshime në kushtet e kontratës nëse haset në parregullsi. “Në një stadium si ky, pa plotësimin e

asnjë kushti, nuk do të zhvillohet më një derbi i këtij niveli”, kishte thënë kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, në nëntor të vitit 2021, pasi kishte përcjellë derbin lokal midis Gjilanit dhe Dritës. Ndërkohë, Ministria e Sportit ka reaguar duke thënë që procedura e prokurimit të këtij stadiumi nuk është pezulluar, porse palët pjesëmarrëse në tender kanë afatet e paraqitjes së kërkesave për rishqyrtim kur ka mospajtime nga ana e tyre lidhur me rezultatin dhe ky afat pritet të përmbyllet brenda pesë ditësh.

Salah ‘bie nga froni’, Raphinha, Mabappe dhe Yamal i prijnë garës së ‘Topit të Artë’ për vitin 2025

Paris, 19 mars - Ceremonia e “Topit të Artë” për vitin 2025 do të mbahet të hënën e 27 tetorit. Deri atëherë do të ketë një garë të fortë mes futbollistëve për ta marrë çmimin më prestigjioz individual.

Mohamed Salah që deri javën e kaluar po i printe garës, tashmë ka rënë në disa pozita, me brazilianin Raphinha që po llogaritet si favorit.

Arsye për këtë duket të jetë eliminimi i hershëm nga Liga e Kampioneve dhe humbja e finales së Carabao Cup.

Raphinha, si kapiten i Barcelonës, po e udhëheq skuadrën drejt triumfit në La Liga, derisa në Ligën e Kampioneve është në çerekfinale dhe është në gjysmëfinale të Kupës së Mbretit. Në vend të dytë momentalisht është Kylian Mbappe i Real Madridit, me francezin që ka shënuar 31



gola deri më tash në të gjitha garat me “Los Blancos”. I treti është tinejxheri i Barçës, Lamine Yamal, që po tregon paraqitje shumë të mira me Blaugranasit. I katërti në listë është Harry Kane i Bayern Munchenit, i cili me shumë gjasë do ta fitojë trofeun e parë në karrierë, me bavarezët që po shkojnë sigurt drejt titullit

të kampionit. Në vend të pestë është momentalisht Ousmane Dembele nga PSG-ja. Francezi po e mban mbi supe Parisin në Ligën e Kampioneve dhe në elitën e futbollit francez, duke qenë top golashënuesi i ekipit. Mohamed Salah që ishte i pari, tashmë zë pozitën e gjashtë në këtë listë, të përpiluar nga “GOAL”.

FIFA ia jep dritën e gjelbër Shqipërisë për regjistrimin e Etnik Brrutit

TIRANË, 19 MARS - Shtëpia Botërore e futbollit i ka dhënë përgjigje Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF) për ish-lojtarin e Kosovës, Etnik Brruti. FIFA i ka dhënë dritën jeshile FShF-së për regjistrimin e Brrutit dhe ai mund të aktivizohet në ndeshjet e muajit maj. Brruti edhe zyrtarisht është pajisur me pasaportë të Shqipërisë dhe do të udhëtojë me “kuqezinjte” për në Angli, raporton “Telesport”. 21-vjeçari këtë muaj e komplettoi kalimin nga Kosova U21 te Shqipëria A. Trajneri Sylvinho e ka ftuar për



ndeshjet e marsit, që Shqipëria i luan në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës të vitit 2026. Kombëtarja shqiptare luan me Anglinë më 21 mars, derisa më 24 mars pret Andorrën në Tiranë.

Kombëtarja e hendbollit fiton grantin ekipor 100 mijë dollarë nga KOK-u

Prishtinë, 19 mars - Kombëtarja A e Kosovës në hendboll, konkurrenca e meshkujve, është përfituese e grantit ekipor rreth 100 mijë dollarë (rreth 92 mijë euro) të ndarë nga Komiteti Olimpik i

Kosovës. Bordi Ekzekutiv i KOK-ut ka përzgjedhur ekipin kombëtar të hendbollit, bazuar në kriteret dhe rezultatet e fundit, të cilat e bëjnë kombëtaren me gjasat më të

përafërta për t'u kualifikuar në Lojërat Olimpike Los Anxhelos 2028. Granti ndahet nga KOK-u, ndërsa fondet janë të Solidaritetit Olimpik të Komitetit Olimpik

Ndërkombëtar dhe dedikohen për kombëtaren më të suksesshme. Granti vlen për periudhën 2025 - 2028. Djemtë e Kombëtares A janë në garë për kualifikim në Kampionatin

Evropian 2026 falë fitores ndaj Ukrainës dhe barazimit ndaj Holandës në grupin 6 kualifikues. Në muajin maj luajnë me Ishujt Faroe në Prishtinë dhe Holandën në udhëtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 560/1
Datë: 19.03.2025

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 12.03.2025 të Qendra e Kompetencës” – Ferizaj shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendrës së Kompetencës - Ferizaj, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KSHD-ja në Durrës (prej 23 deri 26 prill 2025).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2022-2023-2024)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt 23.04.2025 dhe kthimi më dt 26.04.2025
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Berat, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.11428/2024

GYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të propozueses së masës Antigona Maliqi nga Prishtina, me vendbanim të përkohshëm në Zvicër, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat në Prishtinë, ndaj kundërshtarit të sigurimit Lulzim Maliqi nga Fshati Doberçan, me adresë banimi në Prishtinë, lagjja “Marigona 2”, rr. “Malo Gami”, nr.9, tani me adresë të panjohur, lidhur me caktimin e masës së sigurimit, jashtë seancës, me datë 14.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Kundërshtarit të sigurimit Lulzim Maliqi nga Fshati Doberçan, me adresë banimi në Prishtinë, lagjja “Marigona 2”, rr. “Malo Gami”, nr.9, tani me adresë të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Përfaqësuesi i përkohshëm kundërshtarit të sigurimit si në pikën I të këtij aktvendimi i caktohet Have Haliti, avokate në Prishtinë.
- III. Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësojë kundërshtarin e sigurimit deri sa ai ose i autorizuari i saj të mos paraqiten në gjykatë dhe i njëjti i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor.
- IV. Lidhur me këtë aktvendim gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do të jap shpallje e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë, më datë 08.08.2024, propozuesja e masës së sigurimit, Antigona Maliqi nga Prishtina, me vendqëndrim të përkohshëm në Zvicër, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Ekrem

Agushi, avokat në Prishtinë, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndaj këtij kundërshtarit të sigurimit, Lulzim Maliqi, nga fshati Doberçan, tani me adresë të panjohur.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore, ka tentuar që kundërshtarit të sigurimit të ia dorëzojë njoftimin për përgjigje në propozimin për masë, mirëpo nga fletëkthesa e datës 13.08.2024 konstatohet se “Pala nuk gjendet në këtë adresë”.

Me aktvendimin e datës 23.08.2024, Gjykata ka obliguar propozuesen që brenda afatit prej 3 ditësh ta plotësojë propozimin me adresën e saktë të kundërshtarit të sigurimit. Me parashtresën e datës 30.08.2024, përfaqësuesi i propozueses e ka njoftuar Gjykatën se nuk posedon adresë tjetër përveç asaj të ofruar në propozim dhe se kundërshtari i sigurimit jeton jashtë shteti dhe për këtë arsye adresa e vendqëndrimit apo vendbanimit të kundërshtarit të sigurimit, për propozuesen është e panjohur dhe si e tillë adresë tjetër nuk mund të sigurohet.

Gjykata përmes kërkesës së datës 19.09.2024, ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Regjistrimit Civil, ofrimin e të dhënave lidhur me adresën e saktë të kundërshtarit të masës. Kjo Agjenci, përmes përgjigjes së datës 20.11.2024 i ka ofruar gjykatës të njëjtën adresë sikurse në propozim (adresën Lagja Marigona -2, rr. “Malo Gami”, nr.9, Prishtinë).

Gjykata ka tentuar edhe një herë dorëzimin e njoftimit, kundërshtarit të sigurimit, në adresën e dhënë, mirëpo nga fletëkthesa e datës 04.12.2024 është konstatuar se “Pala nuk gjendet në këtë adresë; e panjohur”.

Me nenin 79 par.3 të LPK-së është paraparë se “Gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë;”. Gjykata duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe me qëllim të procedimit më efikas të kësaj çështje konkrete, i ka caktuar kundërshtarit të sigurimit përfaqësuesin e përkohshëm, pasi që adresa e kundërshtarit të sigurimit është e panjohur për propozuesen e masës.

Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësojë kundërshtarin e sigurimit për derisa ai ose i autorizuari i tij të mos paraqitet në gjykatë dhe i njëjti i ka të gjitha të drejtat ligjore dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor.

Nga sa u parashtrua më lart në bazë të dispozitave të nenit 387 par.1 pika (q) lidhur me nenin 79.1, neni 79.3 pika (a), nenet 81, 82 dhe 83 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.11428/2024, me datë 14.03.2025

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Gjyqtarja
Greta Ibraj



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Akicuki Group” SH.P.K. me seli në Vushtrri, Pronar Ardian Shallci, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812236637 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Akicuki Group" D.O.O. Vushtrri, Ardian Shallci donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812236637 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Akicuki Group” L.L.C. with headquarters Vushttri, Ardian Shallci has come to the decision to quit its business: 812236637 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vjosa Kicaj nga Greikoc Suharek shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.u “Luciano Motroni” Prizren.

- "Archihaus" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811902487.

- Faik Ispahiu shpall të pavarëshmë diplomën e nivelit Bachelor të lëshuar më datën 20.05.2003, nr.78 në degën e artit dramatik, drejtimi regjisor, në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Diploma është lëshuar nga UNMIK-u dhe UP-ja.

- "Grindelwald Holding" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811898123.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në telefon 044/171-328.

- Fikrete Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Damjan Gjakovë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Safete Gjuraj Gërqin Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. 1-8 të sh.f.m.u. "7 Shtatori" Gërqin Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.


- Remzi Krasniqi nga Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Damja Gjakovë nga kl. 1-8.

- Burim Krasniqi nga Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u.” Kongresi i manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- Xhevdet Krasniqi Damjani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u."Kongresi i manastirit" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Leonita Luma nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh. Ekonomike "Kadri Kusari".



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

Abirapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L